



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 210, Datë 07.10.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ORHER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1958/1 prot., datë 03.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ORHER” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1958 prot., datë 23.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; në pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; në pikën 1.3 gërma “a”; në pikën 2.1 gërmat “b”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “ORHER” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 2996 Rep., nr. 1957 kol., datë 24.05.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Semanit, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, i nga shoqëria “ORHER” shpk”;
 - Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 2740/3 prot., datë 20.03.2023; Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 11.04.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “*Impianti Fotovoltaik Orher, 2 MW*”. VNM-ja Paraprake e depozituar nga shoqëria është aktualisht e vlefshme (deri më 11.04.2025), por vlerësohet t’i kërkohet asaj të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit dhe nëse po, t’i dokumentojë ato në ERE.
- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet me data të përditësuara.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të informojë se cila është struktura aktuale organizative e saj, pasi ka depozituar një strukturë bashkëlidhur planit të biznesit dhe një strukturë tjetër më vete.

Pika 1.3.

gërma “b”: Shoqëria duhet depozitojë në ERE informacion/dokumentacion në rast se ka pasur ndryshime në vlerën e investimit, një dokument të përditësuar nga banka, në lidhje me financimin e projektit, si dhe të sqarojë raportin në përdiqnje të financimit të projektit, nëse do të realizohet 100% nga banka, apo dhe nga fonde të vetat.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të plotësojë kapacitetin e instaluar të secilës prej njësive, dokumentacion teknik mbi jetëgjatësinë e centralit dhe një datë të saktë për fillimin e operimit.
- **gërma “c”**: Shkresa e OSSH sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes është depozituar në format fotokopje, ndaj do t’i kërkohet shoqërisë që ta depozitojë atë në format origjinal ose fotokopje të njësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ORHER” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI